



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 19/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me Ankesën e z. Lutfi Haziri nga LDK, në seancën e mbajtur më datë 20.10.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Z. Lutfi Haziri, kryetar i Shtabit Zgjedhor të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka parashtruar Ankesë, me të cilën pretendon se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka bërë shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 33 shkronja 1), neni 50 paragrafi 50.3 të cilët në bazë të nenit 15 dhe nenit 18 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, *mutadis mutandis* vlejné edhe për zgjedhjet lokale, neni 3 shkronja 3 (k) të Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009 – Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

FAKTET

Më 19 Tetor 2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga Kryetari i Shtabit Zgjedhor të LDK-së, duke pretenduar se PDK, datë 18.10.2009, ka fyer kandidatin e LDK-së për Prishtinë, z. Isa Mustafa.

Ankesa bazohet në faktet vijuese:

Partia Demokratike e Kosovës ka vendosur pllakate fyese me portretin e kandidatit të LDK-së për kryetar të Prishtinës z. Isa Mustafa, (duke i bashkangjitur fotot nga vendi i ngjarjes). Në këto pllakate nuk është vënë identiteti i PDK-së si sponsoruese. Këto pllakate janë vendosur në shumë rrugë të Prishtinës, si p.sh. rruga “Agim Ramadani” (mbrapa Teatrit Kombëtarë, afër objektit të ri të Ministrisë së Arsimit, afër QKUK-së), në rrugën “Tirana”, në rrugën “UÇK”, në rrugën “Fehmi Lladrovci”, në rrugën “Perandori Justiniani” etj.

Ankuesi më tej pretendon se këto pllakate janë identifikuar si të PDK në bazë të prononcimit të kandidatit të kësaj partie për kryetar të Prishtinës, Astrit Salihu me rastin e prononcimit të tij gjatë aktivitetit zgjedhor në Kodrën e Diellit II, me datë 18.10.2009, të publikuar në TV KLAN KOSOVA në lajmet e 22:30, më saktësisht në ora 23:04 të po kësaj date.

Po ashtu, përveç fotografive, ankesës i është bashkëgjatur edhe një CD me regjistrim të prononcimit të Astrit Salihut në lajmet e 22:30 në TV Klan Kosova, por me kualitet të dobët – e padëgjueshme.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Neni 4.1 (k) i Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2009 – Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatë thotë që gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga veprimet si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

Në kuptim të dispozitës së lartcekur vlerësohet se publikimi e as prononcimi në media, nuk mund të kualifikohen si shpifje në pretendim të nxitjes të subjektit tjetër politik për deri sa ai veprim ka ndodhur në kuadër të parametrave të Kodit të Mirësjelljes.

Të pabazuar vlerësohen pretendimet ankimore se në rastin konkret kemi të bëjmë me veprime në kundërshtim me rregullat e cekura për faktin se ato veprime vlerësohen se nuk janë në kundërshtim me nenin 33 të LZP sepse ato në fakt paraqesin një aktivitet të lejueshëm partiakë fushatën zgjedhore.

Andaj, ankesa e LDK-së refuzohet si e pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 19/2009 më datën 20.10.2009.

